

*Procesverbali i zbardhur i seancës së  
shortit të ekspertëve kontabël  
Dt. 27.11.2024*

27.11.2024

Ora, 13.02

**RENDI I DITËS**


**Hedhja e shortit për përzgjedhjen e ekspertëve kontabël të licensuar për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga 6 subjekte zgjedhore, për zgjedhjet për kryetar bashkie të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024.**

**PJESËMARRJA :**

- **Stafi KQZ:** Znj. M. Çelmeta , z. K. Puleri
- **Parti Politike:**
- **Të tjerë:**

**Znj. M. Çelmeta:** Përshëndetje! Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në vlerësim të rëndësisë dhe transparencës së procesit dhe në zbatim të vendimit 15, datë 26.01.2022 për disa shtesa në udhëzimin nr.14 datë 09.06.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për caktimin e kritereve e procedurave për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjekteve zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore”, ka bërë njoftimin publik në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për pjesëmarrje për të gjithë aplikantët, të cilët shfaqën interes për qenë ekspert kontabël të licensuar për auditimin e fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga subjektet zgjedhore, për fushatën zgjedhore për zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024. Në zbatim të vendimit nr. 15, datë 26 janar 2022, “Për disa shtesa në udhëzimin nr. 14 datë 9.06.2021”, të Komisionerit Shtetëror të

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës së  
shortit të ekspertëve kontabël  
Dt. 27.11.2024*

Zgjedhjeve “Për caktimin e kriterëve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatë zgjedhore”. Kanë depozituar dokumentacionin 6 aplikantë të interesuar për ekspert kontabël të licensuar, për auditimin e fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga subjektet zgjedhore për fushatën zgjedhore për zgjedhjet për kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024. Në një enë transparente vendosen 11 shirita me emrat e subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet e datës 4 gusht 2024 dhe në enën tjetër transparente vendosen 6 shirita me emrat e ekspertëve kontabël të licensuar të përzgjedhur. Atëherë vijojmë me futjen e shiritave në enë. Pra ena e parë është për shiritat me emrat e audituesve dhe ena tjetër është për subjektet zgjedhore. Duke qenë se janë 11 subjekte zgjedhore dhe 6 ekspertë kontabël të licensuar të përzgjedhur, ndarja do të bëhet në 5 ekspertë kontabël të licensuar do auditohen nga 2 subjekte zgjedhore dhe një ekspert kontabël i licensuar do të auditojë një subjekt zgjedhor. Përzgjedhja do të bëhet duke tërhequr nga njëra enë transparente emrit e ekspertit kontabël të licensuar dhe nga ena tjetër transparente emrin e subjektit zgjedhor. Vazhdojmë me futjen e shiritave me emrat e subjekteve zgjedhore në enë. Atëherë vijojmë me përzierjen e shiritave të letrës ose më saktë të audituesve.

Hapim shiritin e parë,

*znj. Fatmira Kastrati.*

Vazhdojmë me enën e dytë, me emrat e subjekteve:

*“Partia e Lirisë”*

*“Partia Demokratike”*

Vijojmë me përzgjedhjen e audituesit të dytë,

*znj. Alda Premçe.*

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës së  
shortit të ekspertëve kontabël  
Dt. 27.11.2024*

Subjektet zgjedhore të cilat ajo do të auditojë janë:

***“Partia e Ballit Kombëtar Demokrat”***

***“Partia Demokristiane e Shqipërisë”.***

Vijojmë përsëri me audituesin, është

***znj. Eneida Rahmani.***

Vijomë me subjektet që ajo do të auditojë. Është,

***“Partia Republikane Shqiptare”*** dhe një tjetër është

***“Partia Fryma e Re Demokratike”.***

Vazhdojmë me audituesin,

***znj. Meri Lika,***

me dy subjektet që ajo do të auditojë, është,

***“Partia e Ballit Kombëtar”*** dhe

***“Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë”.***

Vijojmë me audituesin, me dy që kanë mbetur.

***znj. Silvana Gjikhima,*** vazhdojmë me subjektet e saj, është :

***“Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut”*** dhe

***“Partia Socialiste e Shqipërisë”.***

Vazhdojmë me audituesin e fundit dhe me subjektin e fundit, është:

***znj. Iris Qirjaqi*** dhe subjekti i saj që do të auditojë është:

***“Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar”.***

Faleminderit, mbaruar.

*Vendimi Nr. 202*

***Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA***

